



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, 11 maj 2010
Ref. no.: RK 20 /10

VENDIM

Lënda Nr. KI 31/09

Mehdi Faik Fazliu
kundër

Aktvendimit të Gjykatës Supreme Ap Nr. 141/2004
Gjykatës së Qarkut P. Nr. 233/2002 dhe P. Nr. 265/2002

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gjykata Kushtetuese e përbërë prej:

Enver Hasani, Kryetar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Robert Carolan, Gjyqtar
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Iliriana Islami, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, Gjyqtare
Almiro Rodrigues, Gjyqtar dhe
Altay Suroy, Gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Mehdi Faik Fazliu, aktualisht në vuajtje të dënimit me burgim në Burgun e Dubravës, në Republikën e Kosovës.

Vendimet e kundërshtuara

2. Në Kërkesën e tij, Parashtruesi i kërkesës kundërshton Aktgjykimet Nr. 233/2002 dhe Nr 265/2002 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me datë 23 dhjetor 2003. Po

Kopje e vërtetuar
Overena kopija
Used Copy

ashtu, ai kundërshton edhe Aktgjykimin nr. 141/2004, me datë 29 shtator 2004 të Gjykatës Supreme.

Objekti i shqyrtimit

3. Parashtruesi i kërkesës konsideron se i është shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me Kushtetutë.

Baza juridike

4. Neni 113 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm Kushtetuta); Nenet 20, 27.7 dhe 27.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tej si: Ligji), dhe Neni 54(b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tej si: Rregullorja e Punës).

Përmbledhje e procedurave para Gjykatës

5. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi Kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese më 30 prill 2009. Më 18 shkurt 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit Raportues, Almiro Rodrigues, Kolegji Shqyrtues, në përbërje të Gjyqtarëve Altay Suroy (Kryesues), Gjylieta Mushkolaj dhe Kadri Kryeziu, i ka rekomanduar Gjykatës në të njëjtën ditë që kërkesa të refuzohet si e palejueshme.

Përmbledhje e fakteve

6. Nga dokumentet e parashtruara nga ana e Parashtruesit të kërkesës vërehet se prej datës 11 korrik 2002, ai ka qenë në vuajtje të dënimit me burg në Burgun e Dubravës në Republikën e Kosovës.

7. Më 29 shtator 2004, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin me numër Ap. Nr 141/2004 në lidhje me rastin e Parashtruesit dhe konfirmoi Aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut P Nr 233/2002 dhe P Nr 265/2002 me datë 23 dhjetor 2003, sipas së cilit Parashtruesi u shpall fajtor për veprën penale - Vrasje me paramendim dhe shqiptoi dënimin prej 13 viteve burgim, duke përfshirë kohën e vuajtur në paraburgim.

Pretendimet e Parashtruesit të kërkesës

8. Parashtruesi i kërkesës pohon se ai është dënuar gabimisht për veprën penale e vrasjes, se është i pafajshëm dhe se i është shkelur e drejta e tij e njeriut për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me Kushtetutë.

Vlerësimi për lejueshmërinë e kërkesës

9. Për të qenë në gjendje për të gjykuar Kërkesën e Parashtruesit, Gjykata Kushtetuese së pari duhet të shqyrtojë nëse Parashtruesi i ka përmbushur kërkesat e lejueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë dhe Ligj.

10. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese i referohet Nenit 49 (Afatet) të Ligjit, ku parashihet që:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtuesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht..."

11. Gjykata Kushtetuese thekson se Parashtuesit i është dorëzuar vendimi i Gjykatës Supreme (d.m.th. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Ap. Nr. 141/2004) më 29 shtator 2004.

12. Gjykata Kushtetuese, po ashtu, thekson se Parashtuesi e parashtroi Kërkesën më 30 prill 2009.

13. Në këto rrethana, sipas zbatimit të Nenit 49 të Ligjit, Kërkesa duhet të konsiderohet si e dorëzuar pas afatit kohor.

14. Si rrjedhojë, Parashtuesi nuk mund të konsiderohet se i ka përmbushur kërkesat për lejueshmërinë e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 49 të Ligjit, dhe Nenit 54(b) të Rregullores së Punës, unanimisht,

VENDOS

I. TË HEDHË POSHTË Kërkesën si të palejueshme.

II. Ky Vendim do t'ju njoftohet Palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit.

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Almiro Rodrigues

Prof. dr. Enver Hasani